



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë E-mail: klsh.org.al; site .klsh.org.al

Nr. 198/5 Prot.

Tiranë, më 17.08.2019

**V E N D I M**

**Nr.48, Datë 17.08.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË, TË USHTRUAR NË**

**BASHKINË BULQIZË**

**Për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Bulqizë, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2018, rezultoi se kishte mangësi në drejtim të zbatimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në drejtim të sistemeve në disa llogari, dhe në disa raste në përcaktimin e kriterëve për kualifikim, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, të miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Bulqizë, sipas programit të auditimit nr.198/1, datë 01.04.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 – 31.12.2018.

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## Opiniononi i auditimit.

### **Opiniononi i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

#### **Për drejtimin e Bashkisë Bulqizë.**

Bashkia Bulqizë, për vitin ushtrimor nga 01.01.2018 - 31.12.2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### **Opinion i kualifikuar me rezervë:**

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të **çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin kualifikuar me rezervë”**, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicioni financiar i Bashkisë Bulqizë, më 31 dhjetor 2018, referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **Baza për opinion e kualifikuar me rezervë:**

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

#### **Përshkrimi i çështjeve:**

- Njësia publike, Bashkia Bulqizë, në pasqyrën e pozicionit financiar, të performancës financiare, të lëvizjes së fondeve bazë, si dhe në anekset e pasqyrave financiare që përmbajnë paraqitje të metodave kontabël, apo material shpjegues sipas opinionit, arrihet në konkluzionin për sa më poshtë:

**a-** Pasqyrat financiare nuk japin një pamje të vërtetë dhe të saktë të pozicionit financiar të saj, konkretisht llogaria (107) “Vlera e aktiveve të qëndrueshme të caktuara në përdorim”, me vlerë kontabël 58,552,000 lekë, e pa ndryshuar në periudhën 2018, vlerë e cila është e trashëguar nga ish/komuna Shupenzë, “Ujësjiellës” sha Bulqizë dhe “Ujësjiellës” sha Krastë, me argumentin “Subvencion për investime”. Kjo llogari nuk është mbyllur në fund të periudhës raportuese, **nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie**, si dhe nuk ka të dhëna analitike mbi përmbajtjen e saj, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; UMF nr. 28, datë 18.12.2014, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”.

**b-** Në hartimin, ndërtimin dhe saktësimin e pasqyrave financiare, në përfundim të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve (të qëndrueshme të patrupëzuara, të trupëzuara, qarkulluese, afatshkurtra dhe afatgjatë), për dy periudhat raportuese 2017 dhe 2018, u konstatua se: rezultati i inventarizimit fizik të aktiveve nuk i ka shërbyer përgatitjes, hartimit, ndërtimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore (bilanci kontabël) me anekset përkatëse, për pasojë nuk pasqyrohet i saktë realiteti i gjendjes fizike të aktiveve e pasiveve, me diferenca sa më poshtë:

**b/1** Për vitin 2017 diferencat në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike në përmbledhëse e inventarëve fizik dhe gjendjes kontabël e deklaruar në pasqyrat financiare, ku më të konsiderueshme diferenca:

- më pak (*mungesë*) në gjendjen fizike pasqyrohen në llog.(214) shuma 9,658,104 lekë,
- më tepër në gjendjen fizike pasqyrohen llog.(218) shuma 33,840,620 lekë;
- llog.(31) shuma 249,996 lekë.

**b/2** Për vitin 2018 diferencat në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike në përmbledhëse e inventarëve fizik dhe gjendjes kontabël e deklaruar në pasqyrat financiare, ku më të konsiderueshme diferenca:

- më pak (*mungesë*) në gjendjen fizike pasqyrohet llog.(213) me shumën 28,634,024 lekë (*megjithëse rezulton se, nuk është kryer inventari fizik*);
- më pak (*mungesë*) llog.(214) me shumën 7,372,184 lekë
- më pak (*mungesë*) llog.(32) me shumën 1,524,651 lekë;
- më tepër në gjendjen fizike pasqyrohet llog.(212) me shumën 30,053,219 lekë (*megjithëse rezulton se, nuk është kryer inventar fizik*);
- më tepër në gjendjen fizike pasqyrohet llog.(218) në shumën 35,388,521 lekë.

Komisioni inventarizimit në përfundim të procesit në asnjë rast nuk i ka sistemuar këto diferenca mungesa dhe teprica të rezultuara ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël (*vlera historike*) të evidentuara në pasqyrat financiare, veprim në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”.

#### **Opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Bulqizë<sup>1</sup>**

Në kemi audituar përputhshmërinë<sup>2</sup> e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Bulqizë, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2018.

#### **Opinion i kualifikuar me rezervë.**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Bulqizë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin me rezervë”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

#### **Baza për opinion e kualifikuar me rezervë:**

Bazuar në punën e kryer të auditimit, opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përse i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi. Kemi konstatuar se:

**1-** Në Bashkinë Bulqizë, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm;

**2-** NJAB në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun dhe nuk janë zhvilluar auditime të thelluara në drejtim të prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, planifikim-zhvillimit të territorit dhe administrim-menaxhim të aseteve pronë e bashkisë. Nuk ka nxjerrje përgjegjësie si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në të gjitha

<sup>1</sup> *ISSAI 4000* – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

<sup>2</sup> Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

rastet, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. VII, pika 7.

**3-** Detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, llogaria (401 -409) në fund të vitit 2018 është **në vlerën 86,658,505 lekë.**

**4-** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve (llogaria 468) konstatohet se në fund të periudhës është në **vlerën 104,782,099 lekë**, nga të cilat vlera 2,050,000 lekë për 18 subjekte janë penalitetet e pa kontabilizuara, që i përkasin personave përgjegjës të konstatuara nga KLSH dhe të miratuara nga APP.

**5-** Nga auditimi në Drejtorinë e Tatim Taksave rezultoi se në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 317 subjekte të biznesit të vogël dhe 19 biznesit të madh si dhe 8 subjekte shtetërore, **për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,806,412 lekë**, ndërsa në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 280 subjekte të biznesit të vogël dhe 32 biznesit të madh dhe 4 subjekte shtetërore, **llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,859,177 lekë.**

**6-** Në Bashkinë Bulqizë, kanë ushtruar aktivitet 81 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKB, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në **vlerën 682,983 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenet 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**7-** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë **nuk ka krijuar regjistrin elektronik** me të dhëna, për hapjen e kartelave individuale të abonentëve familjarë, hartimin e regjistrimit themelorë për abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.

**8-** Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Bulqizë, për vitet 2017, për objektet e ndara sipas kategorive të cilat janë pajisur me leje legalizimi, nuk është paguar taksa ndikimit në infrastrukturë me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 5,151,232 lekë.**

**9-** Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Bulqizë, nuk është arkëtuar vlera prej **2,331,188 mijë lekë**, nga kontratat e qerasë për sipërfaqet që kanë në përdorim të kontraktuarit, duke krijuar mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e Bashkisë, si dhe për këtë sipërfaqe nuk janë ri klasifikuar në fond pyjor/kullosor.

**10-** Nga Bashkia Bulqizë nuk është bërë evidentimi i sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, si dhe nuk i është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore, për arkëtimin qirasë në vlerën 3,545,437 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë për këtë vlerë.

**11-** Nga auditimi rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në 4 procedurat e prokurimit:

- “Sistemim asfaltim i rrugës së shkollës, blloku i poshtëm, lagja e Re, Bulqizë, faza I, nga pik. 1 - pik. 10 + degëzimet”,
- “Qendra e qytetit të ri, sheshi para ish Këshillit të Rrethit”
- “Rikonstrukcion i Godinës + shtesë kati Bashkisë Bulqizë”

rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë

29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**12-** Në zbatimin e 2 kontratave të punimeve civile u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm të punimeve, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, konkretisht:

- Kontrata me objekt “Sheshi ish Këshilli i Rrethit”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **288,960 lekë pa TVSH**.

- Kontrata me objekt “*Sistemim Asfaltim i Rrugës së Shkollës, Blloku i Poshtëm, Lagja e Re, Bulqizë, Faza I nga Pik 1 – Pik. 10 + degëzimet*”, Bashkia Bulqizë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **172,464 lekë pa TVSH**.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH-së si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Bulqizë:**

Drejtimi i Bashkisë Bulqizë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **A- MASA ORGANIZATIVE**

**1- Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Bulqizë gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen deri në një farë mase dhe funksionojnë përgjithësisht mirë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

-Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21.

- Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

-Në lidhje me monitorimin: Nuk ka realizim të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të evidentojë dhe mbikëqyrë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. (trajtuar më hollësisht në faqet 38 -39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1/1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një strategjie të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

### **Menjëherë**

**2- Gjetje nga auditimi:** NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, fusha e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, fusha e planifikim-zhvillimit të territorit dhe fusha e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësie si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në të gjitha rastet, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. VII, pika 7. (trajtuar më hollësisht në faqet 39 -41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2/1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të jetë efeciente dhe të zbatojë standardet e auditimit në organizimin dhe funksionimin e saj në të gjitha fazat e procesit të auditimit.

**2/2 Rekomandimi:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

**Menjëherë.**

**3- Gjetje nga auditimi:** Njësia publike për periudhat raportuese 2017 e 2018, nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi mungon struktura e posaçme për pranimin, kontrollin e përpunimin e informacionit kontabël të sjellë nga 3 njësi publike në varësi dhe pronësi të Bashkisë, pasi edhe në rregulloren e brendshme e miratuar me Vendimin të Kryetarit nr.117, datë 08.04.2016 “Për organizimin, funksionimin, detyrat e përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Bulqizë”, nuk është e përfshirë në përcaktimin e detyrave e përgjegjësiave në rregulloren e organizimit e funksionimit të brendshëm të Bashkisë. Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale me programin “Excel” i cili nuk mundëson regjistrimin e veprimeve kontabël në përputhje me planin kontabël, ndërkohë që kjo njësi publike, ka në vartësi dhe në pronësi gjithsej 3 entitete njësi publike me bilance më vete, (Nd.Shërbimesh, “Ujësjiellës “sha Krastë dhe “Ujësjiellës sh Bulqizë), ndërsa drejtoria e financës, sektori kontabilitetit nuk ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara, veprime në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap.(I) “Mbajtja e kontabilitetit”, pika 1 “Parimet e përgjithshme”. Mos përgatitja e pasqyrave përmbledhëse të konsoliduara ku të përfshihet gjendja financiare për 3 entitete njësi në vartësi e pronësi (Formati nr. 10) dhe pasqyrat përmbledhëse të konsoliduar e të ardhurave shpenzimeve të funksionimit (Formati nr. 11), është në mospërputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe njësisive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësisive që varen prej tyre si dhe njësisive të menaxhimit, zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, pika 3. (trajtuar më hollësisht në faqet 51 -52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1-Rekomandimi:** Njësia publike Bashkia Bulqizë të parashikojë në organigramë, strukturë me detyra dhe përgjegjësi të reflektuar në Rregulloren e funksionimit për marrjen, hartimin, ndërtimin e kontrollin e pasqyrave financiare të konsoliduara, të cilat të miratohen nga titullari njësisë publike dhe të raportohen në Ministrinë e Financës e Ekonomisë në fund të çdo viti ushtrimor, duke respektuar afatet e miratuara në dispozitat ligjore në fuqi. Njëkohësisht Drejtoria e Financës të organizojë mbajtjen e kontabilitetit me qëllim që Pasqyrat Financiare të fund vitit, të pasqyrojnë të gjitha detyrimet financiare të papaguara përfshi dhe ato të angazhimit të entiteteve në vartësi e pronësi të lidhura me të tretë e në përfundim të përgatiten pasqyrat financiare të konsoliduar të përfshira me gjendjen financiare të njësisive në varësi.

**Menjëherë**

**4-Gjetje nga auditimi:** Për disa llogari të pasqyrave financiare, nuk janë bërë veprimet kontabël të mbylljes së tyre në fund të periudhës raportuese ku disa llogari, të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla *duhej të ishin mbyllur në fund të periudhës raportuese* duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre konkretisht **llog.(107)** “*Vlera e aktiveve të qëndrueshme të caktuara në përdorim*” vlerë kontabël 58,552,000 lekë e pa ndryshuar në periudhën 2018, veprime në mospërputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap.(II), pika 1 “*Procedura të përgjithshme*”, pika 2 “*Funksioni i disa llogarive specifike të planit kontabël*” (trajtuar më hollësisht në faqet 52 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1-Rekomandimi:** Titullari bashkisë e Drejtoria e Financës, të marrin masa dhe të analizojë përmbajtjen e llogarisë mbi dokumentet, duke kërkuar në arkivin e institucionit, në Njësitë Administrative, “*Ujësjetës*” “sha Bulqizë dhe “*Ujësjetës*” “sha Krastë., duke proceduar sipas kërkesave ligjore për të bërë sistemim kontabël llogaria, llog.(107) duke e krahasuar me gjendjet fizike reale të objekteve, në të kundërt të nxirret përgjegjësia ndaj personave përkatës, nëse konstatohen këto përgjegjësi.

*Menjëherë*

**5-Gjetje nga auditimi:** Për arkëtimin e detyrimeve debitorë të krijuara, drejtoria e financës (sektori kontabilitetit) nuk disponon asnjë analizë në lidhje detyrime debitorë, njëkohësisht nuk disponon analize për periudhën e krijimit, afatin e maturimit për likuidim, veçanërisht edhe për mënyrën e përlllogaritjes së penaliteteve, si pasojë e mos likuidimit në afat, apo të përlllogaritjes së kamatëvonesave e interesave për tejkalim në afatin e likuidimit me analizë. Për këto detyrime sektori i kontabilitetit, nuk ka mbajtur llogari analitike për secilin subjekt debitor përfshirë; (subjektet familjare, subjektet fizik e juridik, apo institucione dhe individ, etj), ndërsa disponon vetëm një listë emërore pa asnjë shpjegim për detyrimin individual dhe periudhën e krijimit. Për arkëtimin e detyrimeve debitorë, në dy periudhat raportuese ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Tarifave e Taksave Vendore, apo edhe të Drejtorive të tjera të ngarkuar për vjeljen e detyrimeve të pa likuiduara, nuk është hapur e mbajtur llogari ndërmjetëse, ose transferimin e këtyre aktiveve, në mospërputhje me UMF nr.14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre, si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive. (trajtuar më hollësisht në faqet 53 -55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1-Rekomandimi:** Titullari dhe Drejtoria e Financës, njësia publike bashkia Bulqizë të procedojnë sipas kërkesave ligjore për sistemimin kontabël të llogarive (të drejtat për arkëtim), duke krahasuar këtë llogari me gjendjen fizike reale të saj, në të kundërt të nxirret përgjegjësia ndaj personave përkatës, nëse konstatohen këto përgjegjësi.

*Menjëherë.*

**6-Gjetje nga auditimi:** Analiza e gjendjes kreditore (Detyrimet) e njësisë publike në përgjithësi sipas përmbajtjes së tyre dhe periudhës së krijimit pasqyrohen të kontabilizuar detyrimet kreditore, me llog.(401-408)“*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*” rezulton e



krijuar në periudhën 2017, ndërsa e analizuar rezulton se në kredi të saj ka vlerat e detyrimeve të krijuara nga njësia publike bashkia Bulqizë deri në datë 31.12.2018 gjithsej ndaj **64 subjekteve**, detyrime për tu paguar për fatura, kontrata e bordero, të mbartura nga periudhat raportuese paraardhëse 2017. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor (*trajtuar më hollësisht në faqet 55 -57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1-Rekomandimi:** Titullari dhe Drejtoria e financës në bashkinë Bulqizë të marrin masa të nevojshme që në programet buxhetore pasardhëse, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të programojnë financimin e detyrimeve të pa likuiduara ndaj të tretëve me qëllim uljen në minimum të borxhit financiar duke hartuar grafik për shlyerjen e detyrimeve të evidentuara në pasqyrat financiare.

*Menjëherë*

**7-Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e financës bashkia Bulqizë për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë, asetëve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese. Në kontabilitet për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie e dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si; (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj*), asete të cilat nuk janë regjistruar në ZRPP Bulqizë në pronësi të njësisë publike bashkia Bulqizë. Mungesa e dokumentacionit kontabël e asetëve për periudhat raportuese që kanë cuar në moskryerjen e procesit të inventarizimit fizik, në këto kushte pasqyrimi në aktiv të pasqyrave financiare pa të dhëna kontabël e dokumente justifikuese ka sjell mos regjistrimin në ZRPP Bulqizë në pronësi të njësisë publike bashkisë’, veprime në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*” e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” ndryshuar, Tabela nr.2 (*trajtuar më hollësisht në faqet 57 -59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1-Rekomandimi:** Titullari i njësisë publike bashkia Bulqizë të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e asetëve dhe të pasurive të kaluara me VKM në pronësi të bashkisë, ndërsa Drejtoria e financës, sektori kontabilitetit të marr masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) dhe llog.(212) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkia Bulqizë, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjor të gjendjes së këtyre asetëve. Për këto aktive të trupëzuara, asete e pasuri në pronësi të njësisë publike bashkia Bulqizë, komisioni nuk është kryer procesin e inventarizimit fizik, ndërsa sektori kontabilitetit nuk disponon dhe nuk ka hapur regjistra e kartela të llogarisë analitike për administrimin e gjendjes kontabël me të dhëna të domosdoshme për secilin objekt.

*Menjëherë*

**8-Gjetje nga auditimi:** Në procesin e inventarizimit fizik të asetëve, pasurisë dhe aktiveve të pasqyruara në përmbledhësen dhe në fletë inventarët, ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël deklaruar në pasqyrat financiare, për periudhën objekt auditimi, rezultojnë diferenca të konsiderueshme më pak (*mungesë*) dhe më tepër se gjendja fizike, për çdo llogari. Në përfundim të procesit komisioni i inventarizimit, në asnjë rast nuk ka sistemuar këto diferenca të rezultuara ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël (*vlera historike*) të evidentuara në pasqyrat financiare., veprime në mos përputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 “*Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014*”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu (IV)“*Sistemi kontrollit periodik aktive*”, pika 74 “*Inventarizimi aktive. (trajtuar më hollësisht në faqet 59 - 60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*).

**8.1-Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, sektori kontabilitetit dhe komisioni i inventarizimit fizik të marrin masa dhe të analizojë përmbajtjen e këtyre llogarive mbi bazën e diferencave të rezultuara nga krahasimi i gjendjes fizike reale me gjendjen kontabël, me sistemimin e tyre, sipas kërkesave ligjore me rregullimet përkatëse në kontabilitet, pasqyrat financiare dhe për secilën llogari analitike të secilit aktiv.

*Menjëherë*

**9-Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e pasqyrave financiare të periudhave raportuese (2017 dhe 2018), në llog.(42) “*Personeli e llogari të lidhura me to*” e cila përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit, ndërsa referuar në pagesën e likuiduar në muajin Janar 2018 përkatëse me liste pagesën e personelit rezultojnë pagesa të kryera nëpërmjet U/Shpenzimeve të likuiduara me diferenca që nuk përputhen me gjendjen e pasqyruar në bilanc, në përlllogaritjen e pagave të personelit dhe evidentimit në pasqyrat financiare, në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve e rregullave kontabël*”, UMF nr. 28, datë 18.12.2014 “*Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014 dhe UMF nr. 26, datë 27.12.2007 i ndryshuar me UMF nr. 10, datë 27.02.2008*”. (trajtuar më hollësisht në faqet 61 -62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1-Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, sektori i kontabilitetit, sektori i pagave të marrin masa për sistemimi *llog.(42)* “*Personeli e llogari të lidhura me to*” për diferencat e rezultuara në përlllogaritjen e detyrimeve për pagat e personelit të bashkisë me diferenca më tepër dhe më pak nga shuma e pagesës të likuiduar në muajin janar sipas periudhave raportuese (2018 e 2019, në të kundërt të nxirret përgjegjësia ndaj personave përkatës, nëse konstatohen këto përgjegjësi.

*Menjëherë.*

**10-Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare për “*Studime e projekte*” të administruara në llog.(202), për periudhën raportuese 2017 dhe 2018 është përlllogaritur vlera e amortizimit vjetor dhe akumuluar për aktive (*trupëzuara e pa trupëzuara*) në llog.(219) “*Amortizimi aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” me rritje totale -45,833,866 lekë (-6,854,307)+ (-38,979,559).veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998.“*Për tatimin mbi të*

ardhurat”; UMF nr.5, datë 30.01.2006. (trajtuar më hollësisht në faqet 60 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1-Rekomandimi:** Drejtoria financës, sektori kontabilitetit, të marrë masat për sistemimin e llog.(202) “*Studime e projekte*”, duke evidentuar faktin në se, vërtetë këto studime e projekte janë aktive, për të cilat është përlllogaritur dhe pasqyruar me testim norma e amortizimit, ndërsa për këto aktive nuk është mbajtur e administruar me kartelë llogari analitike, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktivitetit të qëndrueshëm të trupëzuar objektet e përfunduara dhe që i përkasin periudhës pasardhëse.

*Menjëherë.*

**11-Gjetje nga auditimit:** Në përfundim të procesit të inventarizimit komisioni ka evidentuar gjendje fizike e kontabël për 541 artikuj në qarkullim me vlerë 1(një) lekë të pa vlerësuar në aktive të qëndrueshme të trupëzuara e qarkulluese, të evidentuara në llog.(218), sidomos për artikuj (Kompjuterikë) dhe llog.(214) të cilët duhej të ishin vlerësuar me çmimin e artikujve identikë që kanë gjendje, pasi për këto aktive kërkohet të përlllogaritet norma dhe kuota e amortizimit vjetor dhe i akumuluar. Në përfundim rezultati inventarizimit fizik i njësisë publike bashkia Bulqizë nuk i shërben ndërtimit e hartimit të pasqyrave financiare për secilën periudhë raportuese, për pasojë hartimi e ndërtimi pasqyrave financiare (bilanci kontabël) nuk mund të quhet se pasqyron realitetin e gjendjes së aktiveve, pasurisë, asetëve e gjendjes së vlerave materiale të institucionit, veprime në mospërputhje me UMF nr. 28, datë 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (trajtuar më hollësisht në faqet 62 -63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1-Rekomandimi:** Drejtoria e financës, sektori i kontabilitetit, të marr masa për të vlerësuar aktivet rezultuara në procesin e inventarizimit fizik me vlerë 1(një) lekë të evidentuara në llog.(218), sidomos për artikuj (Kompjuterikë) e llog.(214) aktive të qëndrueshme të trupëzuara e qarkulluese, për të cilët duhet të ishin vlerësuar, pasi për këto aktive kërkohet të përlllogaritet norma dhe kuota e amortizimit vjetor e i akumuluar, në të kundërt të nxjerre përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës përkatës nëse konstatohen këto përgjegjësi.

*Menjëherë.*

**12-Gjetje nga auditimit:** Në procesin e inventarizimit, komisioni ka hartuar përmbledhëse inventarizimit, dhe në fletë inventarët ka evidentuar se kanë rezultuar diferenca ndërmjet gjendjes kontabël me atë fizike, ndërsa në asnjë rast nuk është bërë sistemimi i tyre me dokumentim me hyrje për tepricat të 5 (pesë) artikujve me vlerë 431,610 lekë dhe me dalje për 3(tre) artikuj me vlerë 16,213 lekë në ngarkim të personit materialisht përgjegjës, në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (trajtuar më hollësisht në faqet 63 -64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1-Rekomandimi:** Drejtoria e financës, sektori i kontabilitetit, të marr masa për të sistemuar diferencat e rezultuara në procesin e inventarizimit fizik, me dokumentim me hyrje për tepricat të 5 (pesë) artikujve dhe me dalje për 3 (tre) artikuj.

### **Menjëherë.**

**13.Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë, nuk ka hapur regjistra për abonentët familjarë, mungojnë njoftim detyrimi për taksat dhe tarifave vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 , të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar. Nga administrata tatimore e bashkisë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifave vendore si, për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23, pika 2.

*(trajtuar më hollësisht në faqet 44 -45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë të marrë masa, për krijimin e regjistrimit elektronik me të dhëna, për hapjen e kartelave individuale të abonentëve familjarë, hartimin e regjistrimit themelorë për abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.

### **Në vijimësi**

**13.2. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Bulqizë, të marrë masa në fillim të çdo viti buxhetor të plotësojë dhe të dërgojë njoftimet e detyrimeve në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, ku të kërkojë arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

### **Menjëherë**

#### **14. Gjetje nga auditimi:**

-Në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 317 subjekte të biznesit të vogël dhe 19 biznesit të madh dhe 8 subjekte shtetërore, **llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,806,412 lekë.**

-Në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 280 subjekte të biznesit të vogël dhe 32 biznesit të madh dhe 4 subjekte shtetërore, **llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,859,177 lekë.**

*(trajtuar më hollësisht në faqet 45 -46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 317 subjekte të biznesit të vogël dhe 19 biznesit të madh dhe 8 subjekte shtetërore, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,806,412 lekë.

-për 280 subjekte të biznesit të vogël dhe 32 biznesit të madh dhe 4 subjekte shtetërore, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 8,859,177 lekë.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a-** Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**b-** Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Menjëherë**

**14.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës.

a-Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifave të tjera të pa paguara.

b-Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryejë rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë në territorin e saj, aktivitet minerar dhe veçanërisht fabrika pasurimi, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj Bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifave vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

c-Të evidentohen subjektet që administrojnë tokë truall, sipërfaqen e miratuar për ndërtim dhe të parashikojë për këtë sipërfaqe aplikimin e taksës mbi truallin.

**Menjëherë**

**15.Gjetjet nga auditimi:** Në Bashkinë Bulqizë, kanë ushtruar aktivitet 81 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKB, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën 682,983 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

*(trajtuar më hollësisht në faqet 46 -47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 81 subjekteve në QKB dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën 682,983 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurat e prokurimit të audituara për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 75 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë, të marrë masa në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP, për përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim në përputhje me objektin e prokurimit.

**Në vijimësi.**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultuan fatura të likuiduara me vonesë jashtë afateve 30 ditore për arsye të mungesës së dokumentacionit, dërgimit me vonesë të faturave

në drejtorinë e financës nga vetë subjektet etj. Ka fatura të copëtuara në investime për arsye mungese çelje fondi nga buxheti i shtetit. 12 fatura të paguara nga buxheti i vitit aktual mbajnë fatura të vitit paraardhës dhe janë të regjistruara detyrimet të gjitha sipas faturave, të cilat kanë rënduar buxhetin e vitit pasardhës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 41 -44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, si dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime, duke ndjekur radhën e pagesave.

**18.2. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

**Në vijimësi.**

**16- Gjetje nga auditimit:** Pavarësisht nga puna e bërë nga administrata e Bashkisë Bulqizë, për disa nga masat e rekomanduara nga KLSH, Bashkia është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkakhtar nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), sipas vendimit administrativ të dënimit me gjobë.

Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se:

**A. Masa Organizative:** Nga KLSH janë ri kërkuar 15 masa organizative, nga të cilat janë realizuar pjesërisht 3 masa (3.1; 5.1; 14.1), janë në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

**B. Masa Për Shpërblim Demi:** Nga KLSH janë ri kërkuar 24 masa për shpërblim demi, nga të cilat janë realizuar pjesërisht 2 masa (19.1; 21.1), janë në proces zbatimi 19 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa.

**C. Masa Administrative:** Nga KLSH janë ri kërkuar 2 masa administrative, ku 1 masë është realizuar dhe 1 masë është e pa zbatuar.

**D. Masa Disiplinore:** Nga KLSH janë ri kërkuar 7 masa disiplinore ku nuk është realizuar asnjë.

*(trajtuar më hollësisht në faqet 95 -110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1-Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Bulqizë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën 574/9 prot., datë 04.11.2016, respektivisht:

a- Për 13 masa organizative, respektivisht pikat: 1, 3, 4, 7, 8, 9,10, 11, 12, 13, 14, 15, 16.

b- Për 24 masa shpërblim demi në vlerën **59,258,599 lekë**, respektivisht pikat: nga nr. 1 deri nr. 24 .

c- Për masa administrative sipas Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor pika 2, vlera 500,000 lekë,

Për 7 masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”.

**Menjëherë.**

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE E EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE në vlerën 8,981,648 lekë.**

**1-Gjetje nga auditimi:** Njësia publike bashkia Bulqizë, në Pasqyrat e pozicionit financiar (Bilanci) në (Formati nr.7/a) “Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” dhe (Formati nr.7/b) “Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Vlera neto)” për periudhën raportuese 2018, ka realizuar pakësime gjatë vitit (kosto historike) të aktiveve afatgjata me procedurën “**pakësime të tjera**” me vlerën kontabële 8,981,648 lekë e administruar në llog.(215) “Mjete transporti” të shkarkuar nga regjistrat kontabël dhe libri llogarisë për 5 mjete transportit (2 mjete *autovetura* dhe 3 mjete *motorra*). Nxjerra jashtë përdorimit dhe shkarkimi nga librat e llogarisë dhe lëvizja e tyre, nuk është dokumentuar me fletë dalje e konfirmuar me hyrje marrja në dorëzim në Rezervat e shtetit, por vetëm referuar në urdhrin e Ministrit të Turizmit e Mjedisit nr.197, datë 30.05.2018 “Për transferimin e mjeteve motorike të nxjerra jashtë përdorimit pranë rezervave materiale të shtetit” pa asnjë dokumentacion tjetër justifikues, mjete të cilat janë aktive në pronësi dhe në inventar të bashkisë Bulqizë të evidentuara gjendje fizike në datën 31.12.2017, veprimet e kryera janë në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dhe përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të njësisë publike bashkia Bulqizë. ( *trajtuar më hollësisht në faqet 64 -65 të Projekt raportit të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Titullari Njësisë publike bashkia Bulqizë, të analizojë vlerën **8,981,648 lekë e cila përbën efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë publike bashkia Bulqizë**, si pasojë e pakësimit të aktivitetit në llog.(215) “Mjete transporti” për 5 mjete transporti nga të cilat; (2 mjete transporti *auto vetura* dhe 3 mjete transporti *motorë*) të shkarkuara nga regjistrat kontabël dhe libri llogarisë pa dokumentet justifikues, duke ju referuar vetëm urdhrin të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.197, datë 30.05.2018, urdhër i cili kërkon transferimin në Rezervat e Shtetit të mjeteve në pronësi të (Inspektoratit Shtetëror, Mjedisit Pyjeve, Ujërave e Turizmit Dega Rajonale Dibër), ndërkohë ky urdhër i ministrit nuk ka efekt për këto mjete transporti, sepse ato janë aktive gjendje në inventar dhe pronësi të bashkisë Bulqizë, të cilat rezultojnë të dorëzuara në Rezervat të Shtetit jo nga bashkia Bulqizë, por nga (ISHMPUTDR Dibër), në këto kushte nga Titullari bashkisë të kërkohet konfirmimi i hyrjes, kontabilizimit dhe administrimi i këtyre mjeteve në Rezervat e Shtetit, njëkohësisht edhe konfirmimi i transferimit të tyre nga DSHP Bulqizë në kuadrin e reformës territoriale në bashkia Bulqizë.

*Menjëherë.*

## **C . MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1.Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Bulqizë, për vitet 2017, objektet e ndara sipas kategorive të cilat janë pajisur me leje legalizimi për të cilat është përlllogaritur taksa e ndikimit në infrastrukture nga D.P.T.Sh.I.P janë 59 objekte banimi, 16 objekte social-ekonomike, 4 shtesë anësore, 1 shtesë kati, 1 objekt kulti, 1 godinë shërbimi dhe 6 objekte të kombinuara, ndërsa për vitin 2018, objektet e ndara sipas kategorive të cilat janë pajisur me leje legalizimi për të cilat është përlllogaritur taksa ndikimit në infrastrukture nga D.P.T.Sh.I.P janë 74 objekte banimi, 2 objekte social-ekonomike, 13 godinë shërbimi

dhe 12 objekte të kombinuara, në mbështetje të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.06, datë 07.02.2017 “Paketa fiskale për vitin 2017”, nr. 69, datë 26.12.2017 “Paketa fiskale për vitin 2018”, sipas aneksit nr. 5/2 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 5,151,232 lekë. (trajtuar më hollësisht në faqet 47 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për tu pasqyruar në kontabilitet, në pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, si dhe të bashkëpunojë me ZVRPP Bulqizë për parandalimin e regjistrimit dhe njoftimin e qytetarëve dhe subjekte për pagesën në vlerën prej 5,151,232 lekë deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

## Menjëherë

**2.Gjetje nga auditimi:** Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Bulqizë, kryejnë aktivitet për shfrytëzim karriere 9 subjekte në vlerën 3,545,437 lekë për antena 7 kompani celulare, të cilët kanë në përdorim sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme, të cilat kanë lidhur kontratë për sipërfaqet që kanë në përdorim në vlerën 2,331,188 mijë lekë, duke krijuar mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, si dhe për këtë sipërfaqe nuk janë ri klasifikuar në fond pyjor/kullosor, veprim në papajtueshmëri me nenin 17, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar. (trajtuar më hollësisht në faqet 48 -49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë të marrë masa:

- të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë,
- t’i kërkohe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore,
- të ndjekë zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin qirasë në vlerën 3,545,437 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Subjekti     | Sip.m <sup>2</sup> | Dt e lidhjes kontratës | Dt e përf. kontratës | Vlera e kontratës | Paguar për v.2018 | Difer. për tu paguar |
|----|--------------|--------------------|------------------------|----------------------|-------------------|-------------------|----------------------|
| 1  | E...         | 8,876              | 15.05.2017             | 14.05.2027           | 163,920           | -                 | 163,920              |
| 2  | C.... 2016   | 89,606             | 04.04.2017             | 03.04.2027           | 780,000           | -                 | 780,000              |
| 3  | D...Tec      | 28,019             | 15.11.2017             | 14.11.2027           | 1,036,468         | -                 | 1,036,468            |
| 4  | K...         | 7,445              | 09.03.2017             | 08.03.2027           | 57,041            | -                 | 57,041               |
| 5  | S...         | 10,200             | 22.02.2017             | 21.02.2027           | 63,240            | -                 | 63,240               |
| 6  | Y...         | 6,150              | 20.03.2017             | 19.03.2027           | 195,515           | -                 | 195,515              |
| 7  | G...         | 23,690             | 04.04.2017             | 03.04.2027           | 363,518           | -                 | 363,518              |
| 8  | K....(O....) | 49,197.8           | 06.12.2017             | 05.12.2027           | 549,745           | -                 | 549,745              |



| Nr | Subjekti     | Sip.m <sup>2</sup> | Dt e lidhjes kontratës | Dt e përf. kontratës | Vlera e kontratës | Paguar për v.2018 | Difer. për tu paguar |
|----|--------------|--------------------|------------------------|----------------------|-------------------|-------------------|----------------------|
| 9  | K....E....   | 2,475              | 10.02.2017             | 09.02.2027           | 335,990           | -                 | 335,990              |
|    | <b>Shuma</b> |                    |                        |                      |                   |                   | <b>3,545,437</b>     |

Në vijimësi

**2.2.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë të marrë masa:

- të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga kompanitë celulare, duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, deri në bllokimin e veprimtarisë së kompanive celulare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore,
- të ndjekë zbatimin procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin qirasë në vlerën **2,331,188** lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Kompania      | Dt e lidh. kontratës | Dt e përf. kontratës | Vlera e kontratës | Paguar për v.2018 | Detyrime+0.01% kamatëvonese |
|-----|---------------|----------------------|----------------------|-------------------|-------------------|-----------------------------|
| 1   | T-M....       | 25.10.2017           | 24.10.2027           | 191,000           | -                 | 196,157                     |
| 2   | T-M....       | 14.05.2017           | 13.05.2027           | 231,000           | -                 | 235,851                     |
| 3   | T-M....       | 15.05.2017           | 14.05.2027           | 240,000           | -                 | 245,040                     |
| 4   | T-M....       | 04.04.2017           | 03.04.2027           | 300,000           | -                 | 307,200                     |
| 6   | V.....        | 04.04.2017           | 03.04.2027           | 600,000           | -                 | 607,200                     |
| 7   | V.....        | 20.03.2017           | 19.03.2027           | 250,000           | -                 | 256,750                     |
| 8   | P.... C....   | 06.12.2017           | 05.12.2027           | 170,000           | -                 | 172,040                     |
| 9   | P.... C....   | 10.02.2017           | 09.02.2027           | 300,000           | -                 | 310,950                     |
|     | <b>TOTALI</b> |                      |                      |                   |                   | <b>2,331,188</b>            |

Në vijimësi

#### **D- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI :**

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sheshi ish Këshilli i Rrethit”, Bashkia Bulqizë, me vlerë të kontratës 24,210,624 lekë me TVSH, fituar nga BOE “A....” SHPK & “B....” SHPK, përfaqësuar nga OE “A...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **288,960 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3221 prot, datë 23.08.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Bulqizë dhe sipërmarrësit “A...” SHPK (trajtuar më hollësisht në faqet 92 -94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën prej **288,960 lekë** nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3221 prot datë 23.08.2017, me objekt “Sheshi ish Këshilli i Rrethit”, Bashkia Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës së Shkollës, Blloku i Poshtëm, Lagja e Re, Bulqizë, Faza I nga Pik 1 – Pik. 10 + degëzimet”, Bashkia Bulqizë, me vlerë të kontratës 20,180,508 lekë me TVSH, fituar nga OE “E...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **172,464 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2235 prot, datë 12.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Bulqizë dhe sipërmarrësit “E...” SHPK (trajtuar më hollësisht në faqet 94 - 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Bulqizë të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit në të gjitha shkallët e gjyqimit për vlerën prej **172,464 lekë** nga OE “E...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2235 prot datë 12.06.2017, me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës së Shkollës, Blloku i Poshtëm, Lagja e Re, Bulqizë, Faza I nga Pik 1 – Pik. 10 + degëzimet”, Bashkia Bulqizë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**E- MASA DISPLINORE:**

**Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional**

**Për 2 ish-punonjësit** e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Bulqizë pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim, sa vijon:

1. **J.J.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, larguar nga detyra në qershor 2018
2. **L.M.**, me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Veterinarisë, larguar nga detyra në maj 2019.

**F- MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), 7 punonjësve si më poshtë:**

- 1- **X.D.** (juriste), në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për dy procedura prokurimi:

- “Sistemim asfaltim i rrugës së shkollës, blloku i poshtëm, lagja e Re, Bulqizë, faza i, nga pik. 1 - pik. 10 + degëzimet”;
  - “Qendra e qytetit të ri, sheshi para ish Këshillit të Rrethit”;
- 2- D.N.** (inxhinier) në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 1 procedurë prokurimi:
- “Sistemim asfaltim i rrugës së shkollës, blloku i poshtëm, lagja e Re, Bulqizë, faza i, nga pik. 1 - pik. 10 + degëzimet”;
- 3- S.O.** (ekonomiste), në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 1 procedurë prokurimi:
- “Sistemim asfaltim i rrugës së shkollës, blloku i poshtëm, lagja e Re, Bulqizë, faza i, nga pik. 1 - pik. 10 + degëzimet”;
- 4- A.B.** (inxhinier) në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 2 procedura prokurimi:
- “Qendra e qytetit të ri, sheshi para ish Këshillit të Rrethit”;
  - “Rikonstruksion i Godinës + shtesë kati Bashkisë Bulqizë”.
- 5- B.T.** (jurist) në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 1 procedurë prokurimi:
- “Qendra e qytetit të ri, sheshi para ish Këshillit të Rrethit”;
- 6- F.C.** (ekonomiste). në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 1 procedurë prokurimi:
- “Rikonstruksion i Godinës + shtesë kati Bashkisë Bulqizë”;
- 7- D.S.,** në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për 1 procedurë prokurimi:
- “Rikonstruksion i Godinës + shtesë kati Bashkisë Bulqizë”.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë janë sa vijon:

**1- “Sistemim asfaltim i rrugës së shkollës, blloku i poshtëm, lagja e Re, Bulqizë, faza i, nga pik. 1 - pik. 10 + degëzimet”, me urdhër prokurimi Nr. 62, datë 13.03.2017, fond limit 16,915,996 lekë, fituar nga OE** “E...” shpk, në shumën 16,817,090 lekë, për të cilin nga auditimi i kërkesave të veçanta për kualifikim rezulton se NJHDT nuk i ka argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 61 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, konkretisht:

❖ Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i OE) drejtuesin teknik të punimeve në objekt të përfshire në licencën e OE dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, **në kundërshtim** me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Listë-pagesat e punonjësve, shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore për periudhën sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2015-Janar 2017, **të konfirmuar** nga Administrata Tatimore, në kundërshtim me VKM nr.922, datë 29.12.2014, “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave dhe dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 2, pasi OE ka detyrim vetëm të deklarojë listë pagesat nëpërmjet formës elektronike dhe jo ti konfirmojë ato në administratën tatimore, si dhe kërkesës për organizimin e një vizite në kantier e cila është kërkesë është pjesë e kapitullit II. Udhëzime për OE”, Seksioni 1. “Hartimi i ofertës”, pika 1.3 dhe jo e kriterëve për kualifikim.

**2- “Qendra e qytetit të ri, sheshi para ish Këshillit të Rrethit”, me urdhër prokurimi Nr. 157/1, datë 17.07.2017, fond limit 20,334,523 lekë, fituar nga BOE “A...”**

sh.p.k & “B...” sh.p.k, në shumën 20,177,955 lekë, për të cilin nga auditimi i kërkesave të veçanta për kualifikim rezulton se NJHDT nuk i ka argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 61 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, konkretisht:

❖ Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i OE) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e OE dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve. Listë pagesat e punonjësve, shoqëruar **me formularët e deklaramit të pagesave** për sigurimet shoqërore për periudhën sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2015-qershor 2017, të konfirmuar nga Administrata Tatimore**, në kundërshtim me VKM nr.922, datë 29.12.2014, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave dhe dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 2, pasi OE ka detyrim vetëm të deklarojë listë pagesat nëpërmjet formës elektronike dhe jo ti konfirmojë ato në administratën tatimore. si dhe kërkesës për organizimin e një vizite në kantier e cila është kërkesë është pjesë e kapitullit II. Udhëzime për OE”, Seksioni 1. “Hartimi i ofertës”, pika 1.3 dhe jo e kritereve për kualifikim

**3- “Rikonstruksion i Godinës + shtesë kati Bashkisë Bulqizë”, me urdhër prokurimi Nr. 49 / 15.02.18, fond limit 29,166,666 lekë, fituar nga OE “C...” sh.p.k, në shumën 29,107,020 lekë, për të cilin nga auditimi i kërkesave të veçanta për kualifikim rezulton se NJHDT nuk i ka argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 61 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, konkretisht:**

- Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë me i ulët se 60. Kjo dëshmohet me Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për nr e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpërmendur dhe të shoqërohet me listë pagesat e plotësuar rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a dhe formularët e deklaramit të sigurimeve shoqërore, kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.23, datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin në pikën 10, “Të tjera”. Te paraqitjen mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtove, personelit si me poshtë : Kokore minimumi 60 copë; prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë; komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë; tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë; pajisje kundër zjarrit, në pronësi ose me qira jo me pak se 5 copë. Pajisjet e mësipërme të provohen me dorëzimin e faturës së blerjes, ose akti i zhdoganimit, kërkesë është e tejkualuar pasi NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të gjente zbatim VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10 , pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

- Duhet të paraqesë **edhe** certifikatën ISO 27001:2013 Për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Në rast bashkimi operatorësh çdo operatore duhet të paraqesë ISO. Kërkesa

për ISO 27001:2013 është në kundërshtim me objektin e prokurimit pasi ka si objekt: specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës. Kërkesat e përcaktuara në ISO / IEC 27001:2013 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për të gjitha organizatat, pavarësisht nga lloji, madhësia apo natyra. Objekti i prokurimit nuk ka të bëjë me asnjë përcjellje informacioni apo menaxhim informacioni pasi çdo gjë që është e nevojshme për realizimin e këtij projekti është e publikuar dhe nuk përbën aspak informacion sekret apo të klasifikuar. Kjo ISO nuk gjen mbështetje dhe është e panevojshme për këtë objekt prokurimi

**Shënim i Kryetarit:** Për shkak të ngarkesës së përgjegjësit të grupit edhe në ndjekjen e auditimeve të tjera, prokurimet publike (veçanërisht ato me vlerë mbi 10 milion lekë dhe me ofertë fituese mbi 96% të fondit limit si dhe dy studim projektimit për Bashkinë Bulqizë), do të riauditohen brenda muajit nëntor 2019, ose në auditimin e radhës që do të shikohet në 6 mujorin e parë të vitit 2020. Gjithashtu mund të riauditohen pika të tjera që do të vendosë Drejtori i Departamentit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i sigurimit të cilësisë.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.*

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**